


Mortaliteti nga neoplazmat malinje në R. e Maqedonisë së Veriut


Neoplazmat malinje janë ndër shkaktarët më të shpeshtë të vdekjes në mbarë botën. Në R. e Maqedonisë së Veriut, pas sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut, neoplazmat malinje janë shkaku i dytë më i shpeshtë i vdekjes. Në periudhën nga 2010-2023 shkalla e mortalitetit sillet nga 180,3 në 100000 banorë në vitin 2010 deri më 205,0%000 në vitin 2023.

Diagrami 1: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje në R. e Maqedonisë së Veriut, 2010 - 2023



Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje tek meshkujt është më e lartë se sa tek gratë.


Diagrami 2: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje sipas gjinisë në R. e Maqedonisë së Veriut, 2010 - 2023



Mortaliteti nga neoplazmat malinje tek grupmosha mbi 65 vjet


Në periudhën nga 2010-2023 shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje tek grupmosha mbi 65 vjet oscilon dhe sillet nga 881,1 në vitin 2010 deri më 791,3 në vitin 2023 në 100000 banorë.

Diagrami 3: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje në R. e Maqedonisë së Veriut tek grupmosha mbi 65 vjet, 2010 - 2023



Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje tek grupmosha mbi 65 vjet është më e lartë tek meshkujt.


Diagrami 4: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje në R. e Maqedonisë së Veriut tek grupmosha mbi 65 vjet sipas gjinisë, 2010 - 2023



Mortaliteti nga neoplazmat malinje tek grupmosha nga 0-64 vjet


Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje tek grupmosha nga 0-64 vjet është dukshëm më e ulët se shkalla e mortalitetit tek grupmosha mbi 65 vjet.

Diagrami 5: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje në R. e Maqedonisë së Veriut tek grupmosha nga 0-64 vjet, 2010 - 2023



Edhe tek grupmosha nga 0-64 vjet mortaliteti është më i lartë tek meshkujt se sa tek gratë.


Diagrami 6: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje në R. e Maqedonisë së Veriut tek grupmosha nga 0-64 vjet sipas gjinisë, 2010 - 2023



Lokalizimet primare më të shpeshta të neoplazmave malinje

Tek meshkujt, shkaku më i shpeshtë i vdekjes së pasojë e neoplazmave malinje, në periudhën nga viti 2010-2023, janë neoplazmat malinje të bronkeve dhe mushkërive me një shkallë të mortalitetit e cila sillet nga 64,8 në vitin 2010 deri më 58,2 në vitin 2017, 56,1 në vitin 2021, 65,5 në vitin 2022 dhe 68,3 në 100000 meshkuj në vitin 2023.

Diagrami 7: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje të bronkeve dhe mushkërive tek meshkujt në R. e Maqedonisë së Veriut, 2010 - 2023



Tek gratë shkaku më i shpeshtë i vdekjes së pasojë e neoplazmave malinje në periudhën nga viti 2010-2023 janë neoplazmat malinje të gjirit. Shkalla e mortalitetit sillet nga 30,0 në vitin 2010, 32,6 në vitin 2021, 38,5 në vitin 2022 dhe 37,5 në 100000 gra në vitin 2023.

Diagrami 8: Shkalla e mortalitetit nga neoplazmat malinje të gjirit tek gratë në R. e Maqedonisë së Veriut, 2010 - 2023

